



**INSTITUTI I STUDIMEVE  
PËR KRIMET DHE PASOJAT  
E KOMUNIZIMIT**

Nr. 157 prot.  
Tiranë, më 23.04 2025



**UNIVERSITETI I SHKODRËS  
LUIGJ GURAKUQI**

Nr. 1562 prot.  
Tiranë, më 23.04 2025

### **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

I lidhur sot më datë 23. 04. 2025 midis palëve:

**Insituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri**, Institut i pavarur publik me qendër në Tiranë, me NIPT L11618454G, me seli në adresën: Rruga "e Saracëve", i përfaqësuar nga **Drejtori Ekzekutiv Z. Çelo Hoxha**, më poshtë cilësuar si "ISKK".

Dhe

**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"** me adresë Sheshi 2 Prilli, Shkodër, i përfaqësuar nga **Rektori Z. Tonin Gjuraj**, këtu e mëposhte:

Palët me mirëkuptim midis tyre, lidhin këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

#### **NENI 1**

#### **OBJEKTI**

Qëllimi i këtij Memorandumi është krijimi i një kornize bashkëpunimi të ndërsjellë në fushat e kërkimit shkencor, edukimit, botimeve dhe projekteve të ndryshme, duke siguruar respektimin e legjislacionit në fuqi. Këto aktivitete do të kenë si qëllim kryesor informimin e komunitetit mbi pasojat e regjimit komunist, duke ofruar një kuptim të thelluar të pasojave historike dhe sociale që ka lënë ky regjim.

Bashkëpunimi do të përfshijë gjithashtu mundësinë e organizimit të seminareve, konferencave dhe shfaqjeve që do të kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e kujtesës historike për periudhën komuniste, si dhe edukimin e brezave të rinj mbi rëndësinë e këtyre ngjarjeve.

## **NENI 2**

### **BAZA LIGJORE**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në: Ligjin nr.10 242 datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri” neni 5 germat “f”, “h”, “i”, dhe Kodin Civil.

## **NENI 3**

### **ANGAZHIMET E PALEVE**

1. Palët do të organizojnë dhe marrin pjese ne konferenca, seminare dhe aktivitete të përbashkëta.
2. Palët mund të organizojnë gjithashtu seminare, konferenca dhe aktivitete kulturore/sociale, që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta të këtij bashkëpunimi.
3. Palët angazhohen gjithashtu për organizimin e aktiviteteve edukative dhe kulturore, përfshirë zhvillimin e ekspozitave, leksioneve dhe aktiviteteve të tjera, që mund të realizohen individualisht ose në bashkëpunim me institucione lokale.
4. Bashkëpunimi do të përfshijë shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e projekteve arsimore dhe kërkimore, me synimin për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive në fushat përkatëse.

## **NENI 4**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Cdo rregullim ose ndryshim në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve, dhe nuk shoqërohet me kosto financiare.
2. Cdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
3. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat 3 (tre) kopje për ISKK-në , 1 (një) për Universitetin.

**NENI 5**

**HYRJA NE FUQI**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët dhe do të jetë me afat të pacaktuar.

**PËR ISKK**

**DREJTORI EKZEKUTIV**

**ÇELO HOXHA**



**PËR UNIVERSITETIN**

**REKTORI**

**Prof. Dr. TONIN GJURAJ**

